



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 02.11.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **30.10.2023**, të parashtruar nga **Grup i OE Valmir Loshi B.I. & Benita Company**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i QKMF ne Istog"** me Nr. të Prok: **206-23-6380-5-1-2** nxjerr:

V E N D I M

1. **PRANOHET**, si e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e **Grup i OE Valmir Loshi B.I. & Benita Company** e dt. 30.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Ndërtimi i QKMF ne Istog"** me Nr. të Prok: **206-23-6380-5-1-2** kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 26.10.2023.
2. Korrigohet Njoftimi mbi Vendimin e AK të datës 26.10.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, pas korrigjimit, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grup i OE Valmir Loshi B.I. & Benita Company, me date 30.10.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i QKMF ne Istog"** me Nr. të Prok: **206-23-6380-5-1-2**. AK-MSh, me datë 02.11.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

Neni 1, 7, 33, 59, 60, 69, 72 i LPP-së

Neni 47 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Njoftimi mbi vendimin e AK-së është publikuar me dt. 26.10.2023 ku janë kualifikuar 6 operator ekonomik, kurse ne nuk jemi kualifikuar por jemi shpallur si tenderues të eliminuar me arsyetimin se: "Nuk e ka plotësuar kërkesën që të kenë të kryer kontrata te; kategorisë së II për 3 Vitet e fundit në

vlerë prej 3 milion euro. Ju keni prezantuar referenca te objekteve të kategorisë së II në vlerë prej 1,191,928.69 euro, referenca tjera janë të kategorive tjera.

Ky arsyetim i AK-së është i pa qëndrueshëm dhe i pa bazuar sepse nuk është specifikuar saktë se cilat dëshmi-cilat kontrata nuk i ka marr parasysh, prandaj arsyeja e eliminimit është abstrakte dhe e pa definuar.

Sa i përket arsyetimit të lartcekur se kinse nuk kemi ofruar dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar vlerën e kërkuar prej 3 milion euro, ju sqarojmë se ky arsyetim nuk qëndron për faktin se ne kemi ofruar dëshmi të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se kemi përfunduar kontrata të kategorisë së II në vlerën prej më shumë se 3 milion eurove.

Në nenin 8.1 & 8.2 të FTD-së është kërkuar:

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka realizuar me sukses projekte në fushën ndërtimit (objekte të kategorisë II sipas ligjit të Ndërtimit, respektivisht MMPH-04 2017-UA), në vlerë të përgjithshme jo më pak se 3 Milion Euro, gjatë periudhës së shkuar 3 (Tre) vjeçare duke filluar nga data e Njoftimit për Kontratë. Kurse dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar:

Dëshmia 1. Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar formularin standard në Aneksi 4 duke saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit, datën e përfundimit, të dhënat e personit kontaktues dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve. Për Çdo projekt të realizuar kërkohen Referencat ose Raportet - Procesverbalet e pranimit teknik (për investitor privat AK mund ti verifikoj transaksionet financiare).

Te neni 22.3 i FTD-së është përcaktuar si në vijim:

Faktorët të cilët do të merren në konsideratë gjatë ri-ekzaminimit janë:

Faktorët të cilët do të merren në konsideratë gjatë ri-ekzaminimit janë i. Numri më i madh i kontratave me vlerë të madhe (mbi 500,000 Euro) të përfunduara me sukses, që plotësojnë kriterin e kapacitetit teknik të përmendur nën pikën 8.1 më sipër; ii. Numri më i madh i kontratave për ndërtimin e projekteve shëndetësore të kategorisë QKMF ose më lartë nuk përfshihen AMF ambulancat . Shënim fillimisht zbatohet pika (i) dhe pastaj (ii) zbatohet në rast se d) ose më shumë operatorë ekonomik kanë të njëjtin numër kontratash të përfunduara me sukses sipas pikës (i)".

Autoriteti kontraktues në këtë rast na ka diskriminuar neve sepse e plotësojmë në tërësi këtë kërkesë të nenit 8.1 të FTD-së dhe është dashur të kualifikohemi në fazën tjetër, ndërsa nuk është cekur se si e kanë interpretuar kërkesën e dosjes së tenderit autoriteti kontraktues dhe dëshmitë tona.

Nëse ka ekzistuar ndonjë paqartësi apo dilemë në lidhje me dëshmitë e ofruara nga ne për kontratat e kërkuara atëherë është dashur të kërkohen sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.

Neni 59.2 i LPP-së përcakton qartë që "Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve

Nenin 72 të LPP-së ku parashihet: "Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës".

Ne kemi pasur qasje në raportin e vlerësimit të aplikacioneve dhe kemi vërejtur se OE "Menti Shpk&Engineering Group Shpk" nuk ka hy në listë të ngushtë dhe kjo shihet si më poshtë:

Kandidatët ne vijim nuk hynë në listën e ngushtë si rezultat i këtij ri-ekzaminimi.

Oferta Grup i Operatorëve Ekonomik „Menti Sh.o.k.; Engineeing Group \$H.P.K., nuk hynë ne listën e ngushtë si rezultat këtij ekzaminimi për arsye se nuk ka dëshmuar asnjë kontratë te realizuar me vlere te madhe mbi 500,000.00 €, siç është specifikuar ne N.K DT. i. Numri mi i madh i kontratave me vlerë të madhe mbi 500,000 Euro) te përfunduara me sukses, qe plotësojnë kriterin e kapacitetit teknik te përmendur nën pikën 8.1 me sipër.

Nga ky raport kuptohet qarët se Menti Shpk&Engineering Group Shpk nuk i ka plotësuar kërkesat për tu kualifikuar më tutje dhe këtu shihen kundërthëniet edhe të vetë komisionit. Si është e mundur që njëherë të mos futet në listë të ngushtë e pastaj të përfshihet në këtë listë ky OE.

Siç shihet nga raporti i vlerësimit OE Qëndresa&Dashmir Limaj-Condor nuk i kanë dërguar vërtetimet në afatin e kërkuar, ndërsa në vend të këtij OE është përfshirë Menti Shpk&Engineering Group Shpk, në mënyrë të kundërligjshme.

NË këtë rast krijohet përshtypja se ka kurdisje dhe marrëveshje në lidhje me k'ëtë tender dhe kualifikimin në fazën tjetër.

Ne kerni kontrata shumë më shumë se sa OE Menti Shpk&Engineering Group Shpk, prandQj jemi diskriminuar në këtë rast.

Po ashtu kemi më shumë kontrata se sa OE Hidroproject SHPK&Engrup Shpk, OE Construmax SHPK&Top Project SHPK&Harst Group SHPK, prandaj para këtyre tre grupeve të operatorëve ekonomik ne është dashur të kualifikohemi. Ju lutem analizojeni edhe njëherë dëshmitë në lidhje me këta operatorë ekonomik e po ashtu edhe dëshmitë tona të ofruara.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë, rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i aplikacioneve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së sepse ne është dashur dhe duhet të kualifikohemi në fazën tjetër.

Të mos kualifikohemi me këtë arsytim, është më të vërtetë diskriminim i kompanisë tonë, e kur dihet se ne kemi përfunduar shumë projekte të natyrës siç është kërkuar. Po ashtu kemi bërë shpenzime shumë të mëdha derisa kerni arrit në këtë fazë.

Autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 47 të Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik duke mos na kualifikuar për fazën tjetër edhe pse i kemi plotësuar kushtet e pranueshmërisë dhe të kualifikimit të kandidatëve.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, pasi që paragrafi I i këtij neni e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, ndërsa nga AK-së nuk është zbatuar kjo dispozitë sepse neve jemi diskriminuar, edhe pse jemi OE i përgjegjshëm dhe i përmbushim të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Ju sqarojmë se ju si autoritet kontraktues jeni të obliguar që të siguronit që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Ne Plotësimin e Kërkesës për Rishqyrtim te dt. 30.10.2023

Ne me dt.30.10.2023 kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim por qe te njëjtën nuk kemi mundur ti elaborojmë pretendimet tona ankimore ne detaje për shkak te kohës shume te shkurtër për te parashtruar kërkesën për rishqyrtim.

Ne e kemi elaboruar arsyen e eliminimit dhe kemi sqaruar se ne kemi kontrata mjaftueshëm për te plotësuar kërkesën, madje kemi me shume se sa kërkesa e FDT-se.

Megjithatë për shkak te kohës se shkurte për parashtrim te kërkesës për rishqyrtim ne kemi ngrit pretendime ankimore ndaj OE "Menti Shpk&Engineering Group Shpk", Grupin e OE "Hidroproject SHPK&Engrup Shpk", Grupin e OE OE "Construmax SHPK&Top Project SHPK&Harst Group SHPK", se këta operator ekonomik nuk e plotësojnë kërkesën si ne vijim:

Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet te dëshmoj se ka realizuar me sukses projekte ne fushën ndërtimit (objekte te kategorisë II sipas ligjit te Ndërtimit, respektivisht MMPH-04 2017-UA), ne vlerë te përgjithshme jo me pak se 3 Milion Euro, gjatë periudhës se shkuar 3 (Tre) vjeçare duke filluar nga data e Njoftimit për Kontratë.

Po ashtu nuk e kane plotësuar kërkesën si ne vijim.

Te neni 22 .3 i FTD-se është përcaktuar si ne vijim:

Faktorët te cilët do te merren ne konsideratë gjate ri-ekzaminimit janë:

Faktorët te cilët do te merren ne konsideratë gjate ri-ekzaminimit janë i. Numri me i madh i kontratave me vlere te madhe (mbi 500,000 Euro) te përfunduara me sukses, qe plotësojnë kriterin e kapacitetit teknik te përmendur nen piken 8.1 me sipër; ii. Numri me i madh i kontratave për ndërtimin e projekteve shëndetësore te kategorisë QKMF ose me larte (nuk përfshihen AMF ambulancat). Shënim fillimisht zbatohet pika (i) dhe pastaj (ii) zbatohet ne rast se dy ose me shume operatorë ekonomik kanë te njëjtin numër kontratash te përfunduara me sukses sipas pikës (i)".

Grupi i OE Menti Shpk&Engineering Group Shpk, nuk ka asnjë kontratë mbi 500, 000.00 6, prandaj me këto mungesa nuk është dashur dhe nuk ka mundur te kualifikohet ne fazën tjetër.

Ne kemi numër me te madh te kontratave te natyrës se kërkuar, prandaj ne duhet te kualifikohemi para këtyre tre grupeve te konsorciumit.

Ju lutem analizojeni dhe krahasoni kontratat dhe referencat e këtyre tri kompanive ne raport me dëshmitë e konsorciumit tone dhe rezulton qartë se ne kemi me shume kontrata dhe referenca se secili prej tre grupeve që i cekëm më lartë, prandaj ne duhet të kualifikohemi para të tre këtyre grupeve të cekura më lartë.

Pretendimet tona ankimore kanë të bëjnë me dëshmitë për kontrata dhe referenca të këtyre kompanive, e të cilat në raport me grupin që përfaqësojmë ne, kanë më pak kontrata të natyrës siç është kërkuar.

Ne, pasi kemi analizuar raportin e vlerësimit kemi vërejtur se tek rubrika ku është përfshirë stafi, është shënuar i papajtueshëm.

Kërkesa 2. Staf i teknik - Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se posedon me staf teknik min. 40 punëtor, prej tyre së paku 10 punëtor të certifikuar për ushtrimin e punëve profesionale në siguri dhe shëndet në punë sipas Ligjit për Siguri dhe Shëndet në punë.	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	I papajtueshëm
--	-----------	-----------	-----------	-----------	----------------

Ky konstatim nuk është përfshirë në letrën standarde për tenderues të eliminuar, ndërsa ne nuk e dimë se a është lëshim teknik a apo si qëndron puna me këtë konstatim, sepse ne kemi staf më shumë se sa është kërkesë e dosjes së tenderit.

Sa i përket listës së stafit ju sqarojmë se vetëm lista e anëtarit të konsorciumit Benita Company SHPK i përmban 56 punëtorë.

Nëse është fiala për punëtorë të certifikuar për siguri dhe shëndet në punë vetëm anëtari i konsorciumit Benita Company SHPK i ka 52 punëtorë dhe po ua bashkëngjisim 52 certifikatat e këtyre punëtorëve e të cilat certifikata përmbajnë datat para datës së ofertimit.

Po ashtu ju sqarojmë se të gjithë këta punëtorë figurojnë në listën të cilën e kemi dorëzuar me dosje të tenderit.

Njëkohësisht edhe lideri i konsorciumit i ka bashkëngjitur certifikatat e 9 punëtorëve.

Nëse ka pasur ndonjë dilemë në lidhje me këto dëshmi atëherë është dashur të kërkohen sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.

Duke pasur parasysh këto dëshmi, kërkojmë që të aprovohet kërkesa për rishqyrtim dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe gjatë rishqyrtimit të drejtë oferta e konsorciumit tonë dhe ofertat e të tri grupeve

Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore

Sa i përket pretendimeve tuaja ankimore, pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofertës tuaj, sqarimeve dhe dëshmimeve të ofruara në Kërkesën për Rishqyrtim dhe me plotësimin e saj me dëshmi shtesë, pajtohemi me pretendimet e juaja në lidhje me plotësimin e kriterëve të tenderit, pasi që keni dëshmuar se anëtari i konsorciumit Benita Company SHPK i ka 52 punëtorë me certifikata për siguri dhe shëndet në punë, të cilat certifikata përmbajnë datat e lëshimit 03.02.2023 d.m.th. para datës së ofertimit.

Sa i përket pretendimeve tuaja ankimore në lidhje me ofertuesit e tjerë që janë parakualifikuar, pajtohemi me pretendimet e juaja në lidhje me ofertën e Grupi i OE Menti Shpk&Engineering Group Shpk, e cila nuk e ka asnjë projekt me vlerë të madhe mbi 500,000.00 €, por është futur në listën e parakualifikimit për shkak të dështimit të Grupi i OE Qëndresa&Dashmir Limaj-Condor.

Ju keni e keni një projekt të tillë me vlerë 510,585.89 euro, me titull Ndërtimi i SHFMU V. Frasheri dhe ju e tejkalonit ofertën Menti në baze të nënkriterit të përcaktuar në NJK dhe DT si në vijim:

Faktorët të cilët do të merren në konsideratë gjatë ri-ekzaminimit janë i. Numri më i madh i kontratave me vlerë të madhe (mbi 500,000 Euro) të përfunduara me sukses, që plotësojnë kriterin e kapacitetit teknik të përmendur nën pikën 8.1 më sipër; ii. Numri më i madh i kontratave për ndërtimin e projekteve shëndetësorë të kategorisë QKMF ose më lartë (nuk përfshihen AMF ambulancat). Shënim fillimisht zbatohet pika (i) dhe pastaj (ii) zbatohet në rast se dy ose më shumë operatorë ekonomik kanë të njëjtin numër kontratash të përfunduara me sukses sipas pikës (i).

Si përfundim ne do ta korrigojmë Njoftimin mbi Vendimin e AK të datës 26.10.2023.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.


Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit